



IALA Group sh.p.k

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14, H. 6, Ap. 27, 1016 Tiranë, Shqipëri

Cel: +355688033983, E-Mail: info@ialagroup.com

KONTRATË E DHURIMIT TË PJESËVE TË KAPITALIT ("Kontrata")

Sot më datë 06.01.2023, palët e mëposhtme nënshkruajnë këtë Kontratë:

Z. Klevi Kalem, shtetas Shqiptar, lindur më 02.08.1992 në Corovodë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Rr. Besim alla, yzberisht, kashar; mbajtës i ID me numër J20802004I, (në vijim "Dhuruesi");

dhe

Zj. Bleona Shparthi, shtetase Shqiptare, lindur më 20.12.1996 në Korce, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Rr. "Gramoz Pashko", mbajtëse e ID me numër J66220049D, (në vijim "Pranuesi").

(Në vijim Dhuruesi dhe Pranuesi do të përcaktohen bashkërisht si "Palët" dhe veçmas si "Pala").

Kushtet paraprake

- A. Dhuruesi është pronar i 1 kuote e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë **IALA GROUP sh.p.k.**, me seli ligjore në Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 6, Ap. 27, Tiranë, Shqipëri, me NUIS **M12304003B** ("Shoqëria");
- B. Dhuruesi dëshiron ti dhurojë Pranuesit, i cili pranon, 1 kuotë që përfaqësojnë 20% (njëzetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Palët pranojnë të lidhin këtë kontratë që ekzekuton transferimin e kuotës sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Dhurimi i Kuotës

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Dhuruesi i dhuron dhe i transferon Pranuesit, i cili pranon, kuotën e zotëruara në shoqërinë "**IALA Group**" sh.p.k., me seli ligjore në Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 6, Ap. 27, Tiranë, Shqipëri, me NUIS **M12304003B**.

1.1 Titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet nga Dhuruesi tek Pranuesi me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Neni 2

Deklarime dhe Garanci të Dhuruesit

- 2.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i kuotës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj dhe ka të drejtën e plotë për të transferuar pronësinë e Kuotës tek Pranuesi.
- 2.2 Dhuruesi deklaron dhe garanton se kuota është tërësisht e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë sigurorese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.



Neni 3
Korrespondenca

- 3.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen pranë adresës së komunikuar të Dhuruesit dhe të Pranuesit.
- 3.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të dërgohen me anë të letrës rekomande me kthim përgjigje ose postë elektronike.

Neni 4
Shpenzimet dhe Regjistrimi në QKB

- 4.1 Shpenzimet për lidhjen e Kontratës do të jenë në ngarkim të Dhuruesit dhe të Pranuesit në pjesë të barabarta.
- 4.2 Dhuruesi autorizon Pranuesin për të kryer regjistrimin e Kontratës dhe të transferimit të pronësisë së Kuotës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB").

Neni 5
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet eskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6
E drejta e zbatueshme

Kjo kontratë dhe të drejtat e detyrimit e Palëve do të rregullohen në bazë të së drejtës shqiptare në fuqi.

Neni 7
Vlefshmëria – Origjinalet

Kjo kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga Palët. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje origjinale.

Dhuruesi:

Z. Klevis Kalemli



Pranuesi:

Zj. Bleona Shparthi

Bleona Shparthi

